

Vështrim mbi Treguesit Kryesorë të Zhvillimit Ekonomik të Shqipërisë

Sekretariati i Këshillit të Investimeve

Korrik 2020


Kjo është një përmbledhje e indikatorëve kryesorë makroekonomikë në Shqipëri dhe vendet e Ballkanit Perëndimor të publikuar nga burime zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ky dokument publikohet nga Sekretariati i KI që nga viti 2015 për t'u ardhur në ndihmë përdoruesve të mundshëm të tij.


Dokumenti publikohet dy herë në vit dhe përmban informacionin më të fundit të disponueshëm deri në datën e publikimit.

Dokumenti nuk paraqet pikëpamjet e Sekretariatit ose Këshillit të Investimeve

Ecuria e Rritjes Ekonomike



Rimëkëmbja ekonomike e Shqipërisë e nisur nga viti 2015, u ngadalësua përgjatë vitit 2019, ku sipas vlerësimeve më të fundit të INSTAT ekonomia u rrit me vetëm **2.2%** krahasuar me një vit më parë





Përballimi i dy emergjencave civile të njëpasnjëshme, Tërmeti i Nëntor 2019 dhe pandemia COVID-19, kanë ulur ndjeshëm parashikimet e rritjes ekonomike të Shqipërisë, dhe jo vetëm, përgjatë **vitit 2020**


E Ardhura Për Frymë

Për vitin 2019, e ardhura për frymë e Shqipërisë vlerësohet **5,353 USD** në vlerë korrente, në të njëjtat nivele të një viti më parë

Produkti i Brendshëm Bruto për frymë (USD/frymë)




Produkti i Brendshëm Bruto për frymë (USD/frymë): 2019





Rritja Ekonomike




Bazuar në vlerësimet paraprake të INSTAT, Produkti i Brendshëm Bruto në tremujorin e parë të vitit 2020 i ndikuar nga situata e krijuar nga COVID-19, vlerësohet me rënie prej **2,52 %**, kundrejt tremujorit të parë të vitit 2019.

Kontribut pozitiv kanë dhënë kryesisht degët: Bujqësi, Pyje dhe Peshkim me **+0,71** pikë përqindje dhe Aktivitete të pasurive të paluajtshme me **+0,19** pikë përqindje

Kontribut negativ dhanë kryesisht aktivitetet: Ndërtimi me **-1,29** pikë përqindje dhe Tregti, Transport, Akomodim dhe Shërbim ushqimor me **-0,58** pikë përqindje.

Qarkullimi i Mallrave në Tregtinë e Jashtme




Në gjysmën e parë të vitit 2020 eksportet e mallrave arritën vlerën **125 mld lekë**, duke u ulur me **18 %**, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën **271 mld lekë**, duke u ulur me **15 %**, krahasuar me një vit më parë.

Deficiti tregtar arriti vlerën **146 mld lekë**, duke u ulur me **12 %**, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2019.

Eksportet e Mallrave

Eksporte sipas produkteve




Eksportet sipas produkteve vazhdojnë të ruajnë strukturën e tyre edhe gjatë 6-mujorit I të vitit 2020, ku pjesa më e madhe janë **Tekstile** dhe **Këpucë** të ndjekur nga Minerale lëndë djegëse, energji elektrike dhe Ushqime piqe dhe duhan.





Importet e Mallrave

Struktura e importeve të mallrave vazhdon të dominohet nga importet e **Ushqimeve, pije, duhan** dhe Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi dhe Produkte kimike dhe plastike.




Eksportet në Shërbime Konteksti Rajonal



Edhe gjatë vitit 2019, Shqipëria vazhdon të renditet e dyta në rajon përsa u përket eksportit të shërbimeve, ku dominojnë Udhëtimet me **62.3%** të totalit të eksporteve në shërbime. Serbia është e para në rajonin e Ballkanit Perëndimor përsa i përket eksportit të shërbimeve

Indeksi i Çmimit të Konsumit




Përgjatë 6 mujorit të parë 2020, inflacioni mesatar me bazë vjetore regjistroi vlerën **1.8%**, më i lartë se një vit më parë, ku Inflacioni regjistroi vlerën **1.5%**.

Bazuar edhe në të dhënat e grafikut, duke filluar nga fundi i vitit 2011, inflacioni mujor me bazë vjetore ka qenë vazhdimisht poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë prej **3%**.

Forca e Punës

Norma e papunësisë




Gjatë tremujorit I 2020 Shkalla e papunësisë ka vijuar ritmin rënës të viteve të fundit, duke shënuar një ulje **0.1 p.p** krahasuar me një vit më parë.

Qarqet me normë papunësie më të ulët për popullsinë 15+ vjeç janë: Gjirokastra (6,0%), Elbasani (6,4%), dhe Kuksi (7,2%) ndërsa qarku me shkallë papunësimi më të lartë është qarku Lezhë (21,9%), Tiranë (13,9%) dhe Durrës (13,9%).

Paga Mesatare sipas Sektorëve (në Lekë)

Paga mesatare sipas sektorëve të ekonomisë




Pagat më të larta janë regjistruar në sektorin e “Aktivitetëve financiarë dhe sigurimit”, pasuar nga “Informacioni dhe Komunikimi”. Pagat më të ulta janë raportuar në sektorin “Bujqësi, Silvikulturë dhe Peshkim”.

Paga mesatare mujore - është paga bruto që merr një i punësuar për punën që ka kryer

Paga Mesatare dhe Paga minimale

Paga mesatare mujore për një të punësuar dhe paga minimale e miratuar




Paga mesatare gjatë TI 2020 është raportuar në **53,232 lekë** me rritje **3,3%** kundrejt një viti më parë.

Paga mesatare mujore për një të punësuar në sektorin privat ishte **48,272 lekë** me një rritje **2,7%** krahasuar me një vit më parë ; Ndërkohë paga mesatare mujore për një të punësuar në sektorin shtetëror ishte **63,116 lekë**, me një rritje **2,8%** krahasuar me një vit më parë .

Paga minimale ngelet e pandryshuar në **26.000 lekë**

Kosto e Punës për Vendet e Ballkanit Perëndimor



Pagat mesatare për një të punësuar në Ballkanin Perëndimor (EURO)



Paga mesatare bruto më e lartë në rajon është regjistruar në Malin e Zi, e ndjekur nga Bosnjë dhe Hercegovina, ndërkohë Shqipëria vazhdon të ketë pagën mesatare më të ulët në rajon

(Shënim: Instituti i Statistikave të Kosovë s'ende nuk ka publikuar të dhënat për vitin 2019)



Investimet në Shqipëri



Pjesa më e madhe e investimeve në ekonomi vjen nga sektori i brendshëm. Gjatë vitit 2018, FBKF ishte sa **23.9%** e Produktit të Brendshëm Bruto, ndërsa investimet publike ishin në nivelin e **4.8%** të PBB

Shënim: Të dhënat për FBKF 2019 nuk janë publikuar ende



Investimet sipas Sektorëve



Sipas Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve, gjatë 2018, investimet private u rritën me **2.8%**, dhe **38.6%** e Investimeve vinë nga prodhuesit e shërbimeve.

Shumica e Investimeve gjatë vitit 2018, kanë qenë investime në Makineri dhe Pajisje, **33%** e totalit, duke ruajtur të njëjtin trend të vitit të mëparshëm edhe pse më një rënie prej **7%**; Gjatë vitit 2018, janë rritur investimet në Ndërtesa, Ndërtim dhe Instalime, Mjete Transporti dhe Tokë.

Investimet e Huaja Direkte




Gjatë TI 2020, fluksi hyrës i IHD ka rënë me **20%** krahasuar me një vit më parë
Edhe pse flukset hyrëse të IHD kanë qënë mjaft të ndryshueshme sipas cikleve të biznesit, që nga 2015 stoku
i IHD në Shqipëri ka ruajtur një trend rritës deri ne TIV 2019;
Në TI 2020, stoku IHD ra me **3%** krahasuar me një tremujor më parë; ndërkohë krahasuar me një vit më parë
është rritur me **8%**.



Investimet e Huaja Direkte

Stoku IHD sipas vendit të origjinës, milion EURO




Zvicra vazhdon të udhëheqë stokun e IHD-ve në terma vëllimi, edhe gjatë T12020, me **18%** të totalit, e ndjekur nga Holanda dhe Greqia me 14% të totalit;

Dinamika pozitive të IHD-ve vinë nga Bullgaria, ndërkohë Greqia ka ngadalësuar flukset hyrëse të IHD duke filluar nga tremujori I i 2019.



Investimet e Huaja Direkte

Fluksi IHD sipas vendit të origjinës, milion EURO




Bazuar në të dhënat më të fundit të BSH, janë rritur flukset hyrëse të IHD nga Hollanda, Turqia dhe Bullgaria.

Ndërkohë, flukset hyrëse nga Zvicra edhe pse pozitive janë në rënie, e ndjekur edhe nga Austria dhe Greqia.



Investimet e Huaja Direkte


Fluksi IHD sipas aktivitetit ekonomik, milion EURO



Sektorët më tërheqës për IHD-të ngelen **Energjia elektrike, Minierat dhe Industritë Nxjerrëse**, dhe, edhe pse kjo e fundit në rënie duke filluar nga T I 2019.

Fluksi i IHD në Ballkanin Perëndimor

Fluksi i IHD Në Ballkanin Perëndimor, % PBB




Shqipëria renditet e treta në rajon për IHD me **7.9%** të PBB.

Serbia dhe Mal i Zi udhëheqin rajonin për sa i përket flukseve hyrëse të IHD të cilat janë sa **8%** e PBB.

Fluksi i IHD në Ballkanin Perëndimor

Fluksi i IHD Në Ballkanin Perëndimor, milion USD



Flukset hyrëse të IHD në Serbi arritën në **4 miliardë USD** për vitin 2019, ndërsa në Shqipëri ato kapën shifrën e **1.2 miliardë USD**.

Vendi me më pak flukse hyrëse të IHD në rajon është, Kosova me **304 milionë USD**, por me një trend në rritje.


Stoku dhe Profili i Ndërmarrjeve

Struktura e ndërmarrjeve në ekonominë shqiptare dominohet nga ndërmarrje të vogla me 1-4 të punësuar.


Sipas numrit të të punësuarve	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Gjithsej	106,837	111,083	112,537	152,288	160,679	162,452	162,835	162,342
1-4	95,520	99,782	101,025	136,470	145,456	146,304	145,549	144,857
5-9	5,636	5,235	5,387	8,172	7,631	8,023	8,518	8,569
10-49	4,439	4,660	4,647	5,994	5,902	6,297	6,801	6,932
50+	1,242	1,406	1,478	1,652	1,690	1,828	1,967	1,984
Prodhuesit e të mirave	16,413	16,842	16,989	37,950	48,585	53,250	56,916	60,061
1-4	12,592	13,071	13,273	33,255	44,179	48,819	52,269	55,342
5-9	1,718	1,565	1,603	2,080	1,865	1,842	1,858	1,871
10-49	1,650	1,681	1,562	1,971	1,877	1,851	1,987	2,052
50+	453	525	551	644	664	738	802	796
Prodhuesit e shërbimeve	90,424	94,241	95,548	114,338	112,094	109,202	105,919	102,281
1-4	82,928	86,711	87,752	103,215	101,277	97,485	93,280	89,515
5-9	3,918	3,670	3,784	6,092	5,766	6,181	6,660	6,698
10-49	2,789	2,979	3,085	4,023	4,025	4,446	4,814	4,880
50+	789	881	927	1,008	1,026	1,090	1,165	1,188

Ndërmarrjet Aktive sipas Aktivitetit Ekonomik


Ndërmarrjet aktive, fundviti 2019




Ndërmarrje aktive, 2019



Ndërmarrje të reja, fundviti 2019



Kompani të reja, 2019




Renditja e Shqipërisë në Raportet dhe Indekset Ndërkombëtare

Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit, Transparency International					
Vlera 2019	Renditja 2019	Vlera 2018	Renditja 2018	Vlera 2017	Renditja 2017
35	106/180	36	99/180	38	91/180
Indeksi i Lirisë Ekonomike, heritage.org					
Vlera 2020	Renditja 2020	Vlera 2019	Renditja 2019	Vlera 2018	Renditja 2018
66.9	57/180	66.5	52/180	64.5	65/180
Të bërit biznes, Banka Botërore					
Vlera 2020	Renditja 2020	Vlera 2019	Renditja 2019	Vlera 2018	Renditja 2018
67.7	82/190	69.5	63/190	68.7	65/190
Indeksi i Konkurrueshmërisë Botërore, Forumi Ekonomik Botëror					
Vlera 2019	Renditja 2019	Vlera 2018	Renditja 2018	Vlera 2017	Renditja 2017
57.6	81/141	58	76/140		75/137


Treguesi i Lehtësisë Së Të Bërit Biznes

Renditja e vendeve të Ballkanit Perëndimor, Lehtësia e të bërit biznes



Maqedonia e Veriut ka renditjen më të mirë në rajon edhe pse pozitën e saj janë përkeqësuar gjatë vlerësimit të 2020; edhe Shqipëria ka përkeqësuar pozitën e saj gjatë vlerësimit 2020, krahasuar me një vit më parë.

Indikatorët e Të Bërit Biznes



Shqipëria renditet më poshtë në fushën e trajtimit të lejeve të ndërtimit, energjisë, procedurave fiskale dhe zbatimit të kontratave.

Tregtia Përtej Kufijve – DB 2020

Tregtia përtej kufijve - Eksporte, koha dhe kosto

	Shqipëria	Europa dhe Azia Qendrore	Renditja në 190 vende
Koha - Kontroll në kufi (orë)	9	22.1	
Kosto - Kontrolli në kufi (USD)	55	157.5	
Koha - Përgatitja dhe kontrolli i dokumentave (orë)	6	24.3	
Kosto - përgatitja dhe kontrolli i dokumentave (USD)	10	97.9	
Renditja			24


Tregtia Përtej Kufijve – DB 2020

Tregtia përtej kufijve - Importe

	Shqipëria	Europa dhe Azia Qendrore	Renditja në 190 vende
Koha - Kontroll në kufi (orë)	10	21.1	
Kosto - Kontrolli në kufi (USD)	77	162.3	
Koha - Përgatitja dhe kontrolli i dokumentave (orë)	8	24.7	
Kosto - përgatitja dhe kontrolli i dokumentave (USD)	10	93.9	
Renditja			24

Indikatorët e Konkurrueshmërisë

Indikatorët e Konkurrueshmërisë, Renditja e Shqipërisë



Gjatë 2019, indikatorët Infrastruktura, dhe Sistemi Financiar janë përmirësuar; ndërsa indikatorët Institucionet, Sofistikimet e biznesit dhe Inovacioni janë përkeqësuar.

Liria Ekonomike



Indikatori i Lirisë ekonomike është rritur në mënyrë të qëndrueshme në Shqipëri dhe viti 2020 shënon vlerën më të lartë që nga viti 2014.

Ekonomia konsiderohet e moderuar e lirë.


Shqipëria qëndron poshtë mesatares europiane (**69.8**) por mbi mesataren botërore (**61.6**).

Maqedonia e Veriut ka renditjen më të mirë (**41**) në rang botëror midis vendeve të Ballkanit Perëndimor e ndjekur nga Kosova (**53**) dhe më pas Shqipëria (**57**). Sipas radhës më pas vinë Serbia (**65**), Bosnia dhe Hercegovina (**82**) dhe Mal i Zi (**91**).


Treguesit e Lirisë Ekonomike

Treguesit e Lirisë Ekonomike


Sundimi i Ligjit




Efektiviteti rregulator



Madhësia e qeverisë



Liria e të bërit tregti



Shqipëria ka përparuar në kontrollin e deficitit buxhetor, stabilizimin e borxhit publik dhe krijimin e një mjedisi më miqësor ndaj biznesit;

ndërkohë duhet të përmirësojë në mënyrë të konsiderueshme treguesit për sa l përket të drejtat e pronës, efektivitetin gjyqësor dhe integritetin e qeverisë.



Indeksi i Ekonomisë së Dijes / EBRD Knowledge Economy Index

EBRD Knowledge Economy Index 2018

	Renditja (46 ekonomi)	Vlerësimi i përgjithshëm	Institucione për inovacion	Aftësi për inovacion	Sisteme inovative	Infrastruktura TIK
SRB	13	5.13	5.76	5.46	3.26	6.02
MNE	14	5.04	6.2	5.16	2.88	5.92
MKD	22	4.5	5.74	3.83	3.27	5.18
ALB	25	4.36	5.64	4.79	2.36	4.67
BIH	29	4.1	5.04	4.13	2.88	4.35
XKX	35	3.22	4.81	2.75	3.12	2.2

Ekonomia e dijes është një nocion i rritjes ekonomike sipas të cilit Inovacionit dhe aksesit në informacion udhëheqin rritjen ekonomike të një vendi. Për ta matur, BERZH ndërtoi Indeksin e Ekonomisë së Dijes duke marrë në shqyrtim 46 ekonomi.

Shqipëria renditet e 4ta nga 6 vendet e Ballkanit Perëndimor dhe e 25a nga 46 ekonomitë e marra në shqyrtim.